



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, 22 mars 2021  
Nr. ref.:RK 1731/21

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI180/20**

Parashtrues

**Agim Stublla**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në  
Prishtinë, [C.nr.753/15], të 28 shkurtit 2017**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agim Stublla, nga fshati Lluzhan, Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [C.nr.753/15] të 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore e ka pranuar më së largu deri më 25 prill 2017, datë kjo në të cilën, kishte parashtruar ankesën përkatëse në Gjykatën e Apelit. Ndërsa, bazuar në kopjen e fletëkthesës, Aktgjykimin [Ac.nr.2329/17] e 9 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, e ka pranuar më 26 qershor 2020.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura para Gjykatës**

6. Më 26 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 4 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës (i) u njoftua për regjistrim të kërkesës; dhe (ii) iu kërkua që në Gjykatë të sqaroj të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë cenuar përmes aktit të kontestuar të autoritetit publik dhe të dorëzoi vendimet e kontestuara së bashku me vendime tjera apo dokumente që janë relevante për kërkesën e tij.
9. Më 15 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, dorëzoi në Gjykatë këto dokumente: (i) kallëzimin penal të 8 prillit 2019 të dorëzuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) kundër kolonelit të Policisë së Kosovës, përkatësisht R.B.; (ii) përgjigjen nga Zyra e Prokurorit Disiplinor të 20 dhjetorit 2017; (iii) ankesën [nr.C.nr.753/15] e paraqitur në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C.nr.753/15] të 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore; (iv) vërtetimin e punësimit të 25 nëntorit 2008, sipas të cilit, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Policinë e Kosovës në

cilësi të Zyrtarit Policor; (v) përgjigjen e 10 tetorit 2008 nga Kryeprokurori Ndërkombëtar i UNMIK-ut; dhe (vi) Memorandumin Zyrtar nga Drejtoria Rajonale e Policisë lidhur me “*gjendjen shëndetësore*” të parashtruesit të kërkesës.

10. Më 14 janar 2021, Gjykata Themelore u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe iu dorëzua një kopje e saj.
11. Më 21 janar 2021, Gjykata Themelore, mes tjerash, dorëzoi këto dokumente: (i) Aktgjykimin [C.nr.753/15] e 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore; (ii) Aktgjykimin [Ac.nr. 2329/17] e 9 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit); dhe (iii) kopjen e fletëkthesës për pranimin e Aktgjykimit [Ac.nr.2329/17] të 9 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, që tregon që parashtruesi i kërkesës e ka pranuar këtë Aktgjykim më 26 qershor 2020.
12. Më 21 janar 2021, përmes postës elektronike parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që kërkesën e tij t’ia përcjellë personit D.L., për të cilin pretendon se është avokati i tij sepse e ka revokuar autorizimin për përfaqësim nga avokati i mëparshëm, përkatësisht M.D.
13. Më 18 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

14. Parashtruesi i kërkesës paraqitet për herë të tretë në Gjykatë. Kërkesa e parë e tij ishte e regjistruar me numër KI84/10. Përmes këtij rasti, parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar kushtetutshmërinë e (i) Aktgjykimit [P.nr. 129/2009] të 23 shkurtit 2010 të Gjykatës Komunale të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), përmes të cilit ishte shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes, siç është përcaktuar përmes nenit 252 (Vjedhja) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK); (ii) Vendimit [P.nr. 122/VDP/2010] të 19 nëntorit 2010 të Policisë së Kosovës, përmes të cilit parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës; dhe (iii) Aktgjykimit [PKL.nr.69/2010] të 6 gushtit 2010 të Gjykatës Supreme, dhe i cili kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale. Gjykata, kërkesën KI84/10, e shpalli të papranueshme për shqyrtim në merita. Ndërsa, kërkesa e dytë e tij ishte e regjistruar me numër KI74/12. Gjykata vlerësoi se kërkesa KI74/12 përmbante vendime të reja, por që në substancë ishte e njëjtë me kërkesën KI84/10, dhe për pasojë e shpalli të papranueshme, duke arsyetuar se tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe se kërkesa KI74/12 nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.
15. Në rastin e tanishëm, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në cilësi të Zyrtarit Policor në Policinë e Kosovës nga 12 marsi 2001. Më 27 janar 2009, Zëvendës Drejtorit Rajonal për Administratë të Policisë së Kosovës, i ishte drejtuar një shkresë nga Shërbimet Mjekësore të Policisë së Kosovës, duke i rekomanduar që parashtruesi i kërkesës “*të caktohet në ndonjë vend pune ku përgjegjësia është më e vogël, ku nuk ka nevojë që të*

*mbahet arma, dhe mundësisht ku komunikimi me njerëz është më i vogël*". Pasi i njëjti ishte shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes, siç është përcaktuar përmes nenit 252 të KPPK-së, përmes Aktgjykimit [P.nr.129/2009] të 23 shkurtit 2010 të Gjykatës Komunale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, përmes Vendimit [P.nr.122/VDP/2010] të 19 nëntorit 2010, ia shkëputi marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës.

16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale, duke pretenduar se ndërprerja e marrëdhënies së tij të punës me Policinë e Kosovës, ishte shkëputur në mënyrë të kundërligjshme.
17. Më 1 tetor 2012, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C.nr.107/2009], kishte hedhur poshtë të palejueshme padinë e parashtruesit të kërkesës.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale.
19. Më 6 mars 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.4784/2012] e anuloi Aktvendimin [C.nr.107/2009] e 1 tetorit 2012 të Gjykatës Komunale dhe çështjen e ktheu për rivendosje.
20. Më 28 shkurt 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.753/15] e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se (i) vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është nxjerrë në zbatim të drejtë të ligjit, përkatësisht paragrafit 2.4 të nenit 2 (Fusha e Zbatimit) të Udhëzimit Administrativ 15/2008 për Llojet e Shkeljeve të Rënda dhe të Lehta Disiplinore në Policinë e Kosovës dhe të pikës 1.4.1 të paragrafit 1 të nenit 70 (Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit) dhe nenit 85 (Masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës) të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës; dhe (ii) konstatimi i ekspertës gjyqësore mjekësore se parashtruesi i kërkesës *“është në gjendje t'i kryej detyrat e punës në Polici”*, nuk është vendimtarë për të vendosur ndryshe sepse ndërprerja e marrëdhënies së punës është bazuar në shkeljet disiplinore të vërtetuara nga pala e paditur, përkatësisht Policia e Kosovës dhe jo mbi bazën e gjendjes shëndetësore të parashtruesit të kërkesës.
21. Më 25 prill 2017, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me propozimin që (i) të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe të detyrohet e paditura, përkatësisht Policia e Kosovës, që parashtruesin e kërkesës ta kthej *“në ndonjë vend të punës ku nuk nevojitet bartja e armës”*; dhe (ii) t'i kompensohet dëmi material për shkak të mos realizimit të të ardhurave personale për periudhën maj 2010 deri qershor 2016 në shumën e përgjithshme prej 32.890.09 euro. Parashtruesi i kërkesës, përmes kësaj ankese, ndër të tjera, kishte pretenduar se Gjykata Themelore, gabimisht dhe në kundërshtim me provat e administruara, ka vlerësuar se marrëdhënia e punës e tij është ndërprerë për shkak të shkeljes disiplinore, përderisa të njëjtat prova vërtetojnë se e njëjta është ndërprerë *“për shkak të vlerësimit jo të drejtë të gjendjes së tij mendore”*.

22. Më 21 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një parashtrësë në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, lidhur me zgjatjen e procedurave gjyqësore para Gjykatës së Apelit përkitazi me ankesën e tij.
23. Më 20 dhjetor 2017, Zyra e Prokurorit Disiplinor njoftoi parashtruesin e kërkesës se: (i) ankesa e tij është në shqyrtim e sipër në Gjykatën e Apelit; (ii) më 20 qershor 2017, lënda e tij i është ndarë gjyqtarit A.Z.; (iii) vonesat përkatëse janë shkaktuar për shkak *“të rrethanave objektive siç janë ngarkesa e gjyqtarëve me numër të madh të lëndëve, numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve, etj...”*; dhe se, (iv) nuk ka bazë të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor në rrethanat e këtij rasti.
24. Më 9 mars 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2329/2017] e refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar Aktgjykimin [C.nr.753/2015] e 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [C.nr.753/15] i 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuar me Kushtetutë. Parashtruesi i kërkesës nuk qartëson saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore pretendon se i janë cenuar përmes aktit të autoritetit publik që konteston para Gjykatës.
26. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës, pretendon se (i) *“është i kërcënuar me likuidim”*; (ii) *“është politikisht i diskriminuar”*; (iii) *“nuk e lejojnë askund të punojë”* për shkak se ka qenë *“zyrtarë shtetëror dhe S.P.S.”*; (iv) është *“dërguar me dhunë për trajtim psikiatrik nga personi R.B., kolonel në Policinë e Kosovës, dhe për pasojë i është “dëmtuar shëndeti mendor”*; dhe (v) është *“diskriminuar nga gjykata dhe prokuroria dhe se dëshiron kthim në vendin e punës në cilësi të zyrtarit policor”*.
27. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *“Ju lus të verifikoni në tërësi rastin kemi të bëjmë me ndërmarrje kriminale ose grup terrorist[...] kundër shëndetit dhe personalitetit tim.”*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

28. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,*

*mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

30. Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.  
2. Individu mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”*

31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [C.nr.753/15] e 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore. Megjithatë, siç është sqaruar në procedurën para Gjykatës, pasi Gjykata Themelore është njoftuar për regjistrimin e rastit, e njëjta në Gjykatë ka dorëzuar edhe Aktgjykimin [Ac.nr. 2329/17] e 9 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit të nxjerrë pas ankesës së parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit [C.nr.753/15] të 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore.
32. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se (i) Aktgjykimi [C.nr.753/15] i Gjykatës Themelore është nxjerrë më 28 shkurt 2017; (ii) ankesa kundër këtij Aktgjykimi është dorëzuar në Gjykatën e Apelit më 25 prill 2017; (iii) Aktgjykimi [Ac.nr. 2329/17] i Gjykatës së Apelit është nxjerrë me 9 mars 2020 e të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 26 qershor 2020; ndërsa (iv) parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 26 nëntor 2020.
33. Në kontekst të të dhënave të mësipërme, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse kërkesa është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit katër (4) mujorë, siç është përcaktuar përmes nenit 49 të Ligjit. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu thekson se përtej këtij kriteri të përcaktuar në Ligj për parashtrimin e kërkesave para Gjykatës sipas procedurës të përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 të

Kushtetutës, përkatësisht kërkesave individuale, është gjithashtu pika (c) e paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 39  
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe

[...].”

34. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [C.nr.753/15] e 28 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore. Megjithatë, dhe para parashtrimin të kërkesës së tij në Gjykatë, bazuar në të dhënat e dorëzuara në Gjykatë nga Gjykata Themelore, më 26 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte pranuar edhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, përkatësisht Aktgjykimin [Ac.nr.2329/2017] e 9 marsit 2020, të nxjerrë pas ankesës së tij kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë është dorëzuar më 26 nëntor 2020, përkatësisht (i) më shumë se tri (3) vite pas nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; dhe (ii) pesë (5) muaj pasi kishte pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, e rrjedhimisht jashtë afatit katër (4) muaj të përcaktuar në dispozitat e lartcekura të Ligjit dhe të Rregullores së punës. Në rrethana të tilla, Gjykata duhet të konstatojë se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë është dorëzuar jashtë afateve ligjore dhe për pasojë, duhet të shpallet e papranueshme.
35. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Sabri Gunes kundër Turqisë*, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI107/20, me parashtrues *Ismail Guri*, Aktvendim për Papranueshmëri i 3 dhjetorit 2020, paragrafi 41 dhe referencat e përdorura aty).
36. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes Aktgjykimit të kontestuar janë shkëlur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 18 shkurt 2021, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

*Gresa Caka-Nimani*

Gresa Caka-Nimani



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

*Arta Rama-Hajrizi*

Arta Rama-Hajrizi